



Deklaratë për shtyp - 396/05/2020

19.05.2020
Faqa 1 nga 3

Ministrja Gebauer: Mësimdhënia në të gjitha shkollat speciale është përsëri e mundshme

Zyra për shtypin e kancelarisë së shtetit
40213 Düsseldorf
Telefon 0211 837-1134
0211 837-1405
ose 0211 837-1151

Rifillim i veprimtarisë shkollore

Ministria e Shkollës dhe Arsimit ju komunikon:

Ministria e Shkollës dhe Arsimit ka vendosur sot të hapi shkollat speciale me një fokus në zhvillimin mendor dhe zhvillimin motorik dhe fizik. Mësimi tek këto shkolla speciale do të zërë vend që nga 25 Maji 2020. Për këtë procedurë është rënë dakord me të gjithë personat e përfshirë dhe më së fundmi, edhe me bordet e shkollave.

Ministrja e Shkollës dhe Arsimit Yvonne Gebauer u shpreh : „Qëllimi i qeverisë së Republikës është të mundësojë përsëri pjesëmarrjen në mësim deri në pushimet e verës. Kjo vlen edhe për nxënësit në nevojë të mbështetjes edukative speciale për të gjitha fushat e nevojave të veçanta ku kjo gjë është e mundshme për arsye shëndetësore, duke qenë se ato janë veçanërisht të goditura nga mbylljet e shkollave. Është gjë e mirë që duke filluar nga java që vjen fëmijët e shkollave speciale për zhvillim mendor si dhe për zhvillim fizik dhe motorik do të fillojnë shkollimin.“

Duke filluar që nga data 23 Prill, rifillimi i mësimdhënies ballë për ballë ka zënë vend tashmë në shumë shkolla speciale, veçanërisht për ata nxënës të cilët synojnë të diplomohen këtë vit. Qeveria e Republikës dëshironte të ishte në harmoni me shkollat e përgjithshme për sa i përket fillimit të mësimëve. Si rrjedhim, një numër i madh i shkollave speciale dhe i mësimdhënies së përbashkët ishin përfshirë tashmë në hapat e parë drejt rifillimit të mësimdhënies. Ka arsye të ndryshme për faktin që rifillimi i mësimdhënies tek këto shkolla nuk është zhvilluar në mënyrë direkte.

Pajtimi me rregullat e higjienës dhe të distancës, mundësimi i materialit mbrojtës special dhe organizimi i transportit të studentëve, veçanërisht tek shkollat speciale të zhvillimit mendor dhe atij fizik dhe motorik, para-

presse@stk.nrw.de
www.land.nrw

qesin sfida shumë të veçanta për grupet e ndryshme të përfshira në vend. Sqarime të mëtejshme ishin rrjedhimisht të nevojshme në mënyrë që të mundësohet mbrojtja më e mirë për mësuesit dhe fëmijët.

Në mënyrë që t'u jepet të gjithë nxënësve akses i barabartë gjatë kësaj kohe të jashtëzakonshme, është e nevojshme të bien dakord në një plan specifik sipas shkollave anëtarët e një trekëndëshi përgjegjësie që përmban drejtorët e shkollave speciale të zhvillimit mendor si dhe të zhvillimit fizik dhe motorik, autoritetet mbikëqyrëse të shkollave dhe bordet e shkollave. Plani i shkollave siguron se të gjithë studentët statusi shëndetësor i të cilëve u lejon pjesëmarrjen në shkollë mund të rikthehen në shkollë. Qëllimi është të arrihet një marrëveshje me prindërit dhe të përpunohet një plan transparent dhe i detyrueshëm i cili tregon ditët në të cilat nxënësit individualë ose grupet e ndryshme të mësimit do të kenë mësimdhënie ballë për ballë deri në pushimet verore. Sipas rregullit, këto ditë duhet të zënë vend përgjatë veprimtarisë së zakonshme me kohë të plotë në këto shkolla. Kërkesat për distancën , rregulloret e higjienës dhe masat për mbrojtjen nga infeksioni të cilat do të vëzhgohen tek shkollat do të çojnë kryesisht në formimin e grupeve më të vogla të mësimit, njëllonj si tek shkollat e tjera, në varësi të kapaciteteve të mjediseve dhe të stafit.

„Hapja e shkollave speciale të fundit të cilat ishin ende të mbyllura ishte një shqetësim madhor i qeverisë së Republikës. Të gjithë personat e përfshirë ishin të vetëdijshëm për faktin se duhet të ndërmerreshin masa paraprake, veçanërisht në shkollat e nevojave të veçanta me një fokus në zhvillimin mendor si dhe në zhvillimin motorik dhe fizik dhe duhet të diskutoheshin gjerësisht me të gjithë personat e përfshirë. Rregulloret e gjetura tashmë mundësojnë një bazë shumë të mirë për t'u siguruar se nxënësve në këto shkolla të veçanta mund t'u jepet mësim dhe të mbështeten sërish. Jam personalisht gjithashtu jashtëzakonisht e kënaqur në lidhje me këtë gjë ,” tha Ministria Gebauer.

Korrespondencën e shkollës për hapjen e shkollave speciale të zhvillimit mendor si dhe të zhvillimit fizik dhe motorik e gjeni këtu:

<https://www.schulministerium.nrw.de/docs/bp/Ministerium/Schulverwaltung/Schulmail/Archiv-2020/200519/index.html>

Nëse keni pyetje të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni zyrën e shtypit të Ministrisë së Shkollës dhe Arsimit, Telefon 0211 5867-3505.

Faqja 3 nga 3

Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet në adresën e internetit të qeverisë së Republikës www.land.nrw

[Informacion i përgjithshëm për mbrojtjen e të dhënave](#)